

Prishtinë: 14.01.2008
Kodi i ZRrE-së: D_081_2007
Nr. i Referencës: ERO/CPD_R_60_12_2007

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dispozitat sipas Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
4. Ankesën e konsumatorit drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE të datës 04.09.2007 e me numër regjistrimi 110/09 2007;
5. Njoftimi për shkyçje me datë 15.07.2005;
6. Urdhëresa për shkyçje me datë 17.08.2005;
7. Njoftimi për shkyçje me datë 02.12.2005;
8. Përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni të Furnizimit –Departamenti për Konsumatorë të datës 09.07.2007 me numër të referencës 547;
9. Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës
10. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 14.01.2008 morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Fatmir Istrefi (konsumator komercial – 7/01, shifra e konsumatorit DMI - 9012406) D.P.T MARFIGONA, për arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi

Arsyetim

1. Konsumatori në ankesën e tij me datë 21.06.2007 ka kërkuar që t'i zbritet gjoba për shkyçje të cilin e ka ngarkuar KEK Sh.A dhe parapagimi për RTK.
2. Me datë 09.07.2007 KEK Sh.A – Divizioni të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në arsyetimin se në bazë të marrëveshjes Qeveri – KEK Sh.A nuk kemi bazë për zbritjen e taksës për transmetuesin publik. KEK Sh.A ka poashtu ka informuar konsumatorin për të drejtat e tij për ta apeluar përgjigjen e KEK Sh.A në Zyrën e Rregullatorit për Energji.
3. Konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë në DMK të ZRrE-së lidhur me gjobën e shkyçjes që KEK SH.A e ka ngarkuar dhe parapagimin për RTK.

4. Konsumatori në kërkesën e tij ka kërkuar që të mos ta paguaj parapagimin për RTK dhe se t'i hiqet gjoba për shkyçje.
5. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE gjatë analizës dhe shqyrtimit të bërë të dokumentacioneve të ofruara nga KEK Sh.A dhe nga konsumatori, ka propozuar Bordit të ZRrE-së që të refuzoj ankesën e konsumatorit me nr. 110/09 2007 për arsye si në vazhdim:
 - 5.1 Me datë 15.07.2005 KEK Sh.A e ka njoftuar konsumatorin me anë të Njoftimit për Shkyçje për borxhin që konsumatori ka ndaj KEK Sh.A, në bazë të nenit 16.1 a) të Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ishte 265.05 Njoftimi për shkyçje e ka ngarkuar konsumatorin (borxhin e përgjithshëm) në shumë prej 10.00 € plus TVSH, pra e gjitha prej 11.50 €.
 - 5.2 Pas kësaj me pasi që konsumatori nuk i ka plotësuar të gjitha specifikacionet e paraqitura në Njoftimin për Shkyçje, me datë 17.08.2005 ekipi i autorizuar i KEK Sh.A në bazë të Urdhëresës për Shkyçje e ka shkyçur konsumatorin nga rrjeti elektrik, në bazë të nenit 6.1 të Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë. Shkyçje e ka ngarkuar konsumatorin (borxhin e përgjithshëm) në shumë prej 100.00€ plus TVSH, pra e gjitha prej 115.00 €.
 - 5.3 Me datë 02.12.2005 KEK Sh.A e ka njoftuar konsumatorin me anë të Njoftimit për Shkyçje për borxhin që konsumatori ka ndaj KEK Sh.A, në bazë të nenit 16.1 a) të Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje të Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, ku borxhi i konsumatorit deri në atë kohë ishte 264.90 Njoftimi për shkyçje e ka ngarkuar konsumatorin (borxhin e përgjithshëm) në shumë prej 10.00 € plus TVSH, pra e gjitha prej 11.50 €.
 - 5.4 Konsumatori me datë 21.06.2007 iu është drejtuar KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë me një ankesë lidhur me zbritjen e gjobës së shkyçjes dhe zbritjen e taksës për transmetuesin publik.
 - 5.5 KEK Sh.A – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë me datë 09.07.2007 iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar në bazë të marrëveshjes Qeveri – KEK Sh.A nuk ka zbritje për taksën e transmetuesit publik.
 - 5.6 Pas kësaj konsumatori iu është drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE me datë 04.09.2007 e numër regjistrimi 110/09 2007 duke e apeluar përgjigjen e KEK Sh.A të datës 09.07.2007.]
 - 5.7 Ndërsa sa i përket taksës për parapagimin për RTK duhet theksuar se parapagimi për Radio Televizionin e Kosovës është i bazuar në Ligjin Nr. 02/L-47 për Radio Televizionin e Kosovës ku në dispozitat e ligjit ceket:
 - ✓ Në bazë të nenit 20.4 të Ligjit Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njësitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike.

- ✓ Sipas nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 të liruar nga obligimi i cekur me lartë, përfshihen banorët e vendbanimeve ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës ku mungon sinjali cilësor televiziv i rrjetit tokësor, dhe Familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori e veçantë përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale.

5.8 Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve i ZRrE-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRrE-së, përgjigjen e KEK Sh.A dhënë konsumatorit, analizimin e dëshmive të paraqitura dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të Aplikueshme në Kosovë, konstaton se KEK Sh.A ka zbatuar të gjitha procedurat e parapara si rregullin mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë si dhe Ligjin Nr. 02/L-47 për Radiotelevizionin e Kosovës, andaj duke u bazuar në atë se çka u tha më sipër Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE **refuzon** ankesën e konsumatorit si të pabazë.

6. Më 14.01.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **ta refuzojë** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 5 të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, konsumatori ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Kryesuesi i Bordit të ZRrE-së

Anëtarët e Bordit:
